



RAPORTI I PERFORMANCËS SE SHËRBIMEVE TE BASHKISE DEVOLL 2022

(permbledhje)

Raporti i Performancës së shërbimeve është një dokument që informon mbi performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore sipas kërkesave të legjislacionit duke ofruar një tablo të detajuar të arritjeve brenda sektoreve dhe shërbimeve publike kryesore të ofruara nga bashkia gjatë vitit 2022 bazuar në të dhënat financiare dhe teknike. Informacioni për performancën financiare të bashkise vjen në vija të përgjithshme.

Si ta lexojmë kete raport

në nivel indikatorit është sinjalizues për ecurinë e shërbimit.

Proçesi

Për të monitoruar ofrimin e shërbimeve publike bashkia në përputhje me kërkesat e ligjit 139/2015 për vetëqeverisjen vendore ka ngritur një njësi / koordinator për performancën e shërbimeve që ajo ofron. Bazë e monitorimit të shërbimeve është ngritja e një regjistri të performancës së shërbimeve mbi bazën e të cilit hartohet Raporti Vjetor i Performancës së Shërbimeve në bashkëpunim me të gjitha departamentet. Ky proçes është asistuar nga projekti Bashki të Forta me trajnim në terren dhe instrumenta lehtësues (formate për mbledhje të dhenash dhe gjenerim analize). Drejtorite përgjegjëse kanë përzgjedhur indikatorët dhe të dhënat për shërbimet përkatëse, bazuar në databazat ekzistuese për shërbimin dhe listes sugjeruese ofruar nga kompania nenkontraktore. Njesia e performances ka mbledhur dhe validuar të dhënat dhe treguesit, i ka analizuar ato, ka rishikuar vlerat përfundimtare me secilin departament dhe ka finalizuar raportin. Raporti që po prezantohet sot në mbledhjen e radhës në keshillin Bashkiak, është publikuar në faqen zyrtare të bashkisë dhe faqet përkatëse në mediat sociale dhe do të përdoret edhe në konsultimin publik para aprovimit të buxhetit 2024-2026.



- Bashkia ka shpenzuar fonde për planifikimin menaxhimin dhe administrimin duke rritur performancën si në shpenzime korrente ashtu edhe në realizimin e investimeve, të cilat gjatë 2022 janë realizuar 100%. Bashkia dhe këshilli bashkiak kanë qenë më transparent duke bërë konsultim me publikun për buxhetin dhe paketën fiskale dhe realizuar 100% mbledhje të hapura për publikun.
- Është përmirësuar situata financiare falë mirëadministrimit të burimeve financiare dhe punës së mirë të administratës tatimore dhe përdorimit më të kujdesshëm të buxhetit
- Policia bashkia ka mbështetur popullatën dhe strukturat e qeverisë vendore dhe asaj qendrore duke zgjidhur tërësisht të gjitha rastet e ankesave apo konflikteve në komunitet dhe mbështetur IKM-të.
- Bashkia ka përmirësuar shërbimin e emergjencës civile duke rritur ndjeshëm numrin e rasteve të identifikuara dhe të dëmshpërblyera, rritjen e inspektimeve për të paraprirë rasteve të rrezikut nga zjarri etj.
- Bashkia ka përmirësuar rrjetin vaditës dhe kullues duke e bërë atë funksional, për rrjedhojë kjo ka sjellë që në fund të vitit 2022 rreth 90% e tokës bujqësore të mbulohet nga shërbimi i vaditjes dhe kullimit, gjë që ka çuar në rritjen e prodhimit bujqësor të fermerëve lokal.
- Bashkia ka plan menaxhimi për të gjithë sipërfaqen pyjore dhe kullotë nën administrimin e saj. Ajo është kujdesur që të shtojë numrin e fidanëve me mbi 3000 rrënjë në sipërfaqen e shfrytëzuar përgjatë vitit 2022.
- Bashkia ka përmirësuar infrastrukturën rrugore në territorin e saj, duke shtuar me 22 km linear rrugë të re. Kjo ka sjellë që të gjitha fshatrat të kenë akses në të 36 qendrat që ofrojnë shërbime publike në gjithë bashkinë.
- Është përmirësuar cilësia e menaxhimit të mbetjeve pa rritur koston mesatare për njësi të këtij shërbimi Bashkia depoziton mbetjet e saj në landfillin rajonal të Korçës, dhe mbulon pothuajse tërësisht popullsinë e saj me këtë shërbim (100% në pjesën urbane të saj dhe mbi 80% në pjesën rurale të saj).
- Bashkia mirëmban pothuajse gjysmën e sipërfaqes së gjelbër publike duke rritur mundësitë për komunitetin të ketë hapësira rikrijuese dhe shplohëse.
- Ajo ka shtuar ndricimin publik si një aspekt shumë i rëndësishëm i sigurisë në komunitet.



- Bashkia rritur perpjekjet për mirmbajtjen e ujësjellsit dhe kanalizimeve, për tu qëndruar sa më pranë qytetarëve në nevojat e tyre bazike, në mënyrë që çdo qytetar të furnizohet me ujë. Buxheti i shpenzuar për këtë shërbim është realizuar 100% dhe ky buxhet është përdorur vetëm për investimet.
- Përmiresimi i kushteve në arsimin bazë, parashkollor, dhe atij të mesëm, rritje e vemendjes për shtresat në nevojë dhe me shumë mbështetje përmes strehimit social, kanë qenë tendence e bashkise përgjate vitit 2022.

Si përfundim:

Gjatë vitit 2022 buxheti i bashkisë është zbatuar në mënyrë të ekuilibruar dhe është realizuar në masën 88%, duke përdorur 93% të të ardhurave të bashkisë.

Përkujdesi social, Arsimi Bazë dhe parashkollor, administrata dhe infrastruktura rrugore janë shërbimet më të financuara nga bashkia gjatë vitit 2022.

Bashkia ka përmirësuar shërbimet e ofruara për komunitetin me anë të një fondi investimesh prej 231.5 milionë lekë, përmes të cilit janë financuar shërbime të tilla si: Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime, Rrjeti rrugor rural, Arsimi Bazë dhe Parashkollor, Strehimi etj. Bashkia ka realizuar investimet për vitin 2022 rreth 56% më të larta sesa ato në vitin 2021. Projektet e investimeve në vitin 2022 janë realizuar në masën 93% krahasuar me planin e këtij viti.

Bashkia ka synuar të përmirësojë eficiencën financiare dhe mirë administrimin e parave duke ofruar më shumë shërbime dhe cilësi më të lartë të tyre për komunitetin. Jane marre parasysh prioritetet e komunitetit dhe rezultojnë se është ndërhyrë për përmirësimin e nevojave të banorëve, sidomos në zonat rurale, sikurse janë rrugët lidhëse të fshtatrave dhe Njësi Administrative, vënia në funksion e veprave vadi tëse për tokat bujqësore, apo furnizimi me ujë të pijshëm i banorëve në zonat rurale.

Bashkia po synon të rrisë eficiencën financiare dhe mirë administrimin e parave duke ofruar më shumë shërbime dhe cilësi më të lartë të tyre për komunitetin.



- Detaje të performancës së shërbimeve të ofruara nga bashkia jepen në detaj në këtë raport, këtu janë përzgjedhur ato programe buxhetore / shërbime për të cilat janë shpenzuar më së shumti para dhe kemi informacion të mbledhur më të detajuar.

Shpenzimet buxhetore sipas programeve

Shërbimi	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Përkujdesi Social	232 039	268 387	280 906	284 066	99%
Rrjeti rrugor rural	79 231	71 156	98 260	108 620	90%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	76 303	73 132	127 983	157 970	81%
Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	19 752	95 324	84 314	84 586	100%
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	115 026	120 096	109 028	119 898	91%
Shërbimet Publike Vendore	17 845	31 349	65 342	79 826	82%
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	26 377	32 959	26 820	33 348	80%
Menaxhimi i mbetjeve	42 203	31 907	32 893	49 537	66%
Planifikimi Urban Vendor	4 802	5 025	10 889	12 772	85%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	4 374	4 223	5 295	10 271	52%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	26 320	22 830	27 072	41 200	66%
Sport dhe argëtim	25 195	14 289	11 324	11 983	95%
Strehimi Social	18 688	14 414	24 487	32 006	77%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	2 346	5 944	14 402	18 493	78%
Shërbimet e Policisë Vendore	4 635	6 925	7 863	8 581	92%
Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatoreve	1 547	2 085	2 041	2 495	82%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	5 865	6 414	8 947	16 024	56%

Faleminderit!



Projekti Bashki te forta ne kuader te misionit te tij per te mbeshtetur bashkite ne krijimin e politikave te forta publike ne perputhje me buxhetin e tyre ,ne bashkepunim me njesine e performances te ngritur ne B.Devoll ne funksion dhe zbatim te ligjit te veteqeverisjes v.ka ngritur regjistrin e performances duke finalizuar kete raport performance i cili eshte një dokument i cili informon mbi ofrimin e sherbimeve publike duke ofruar nje tablo te detajuar te arritjeve brenda sek dhe dr gjate vitit 2022!

Nj e P ka mbledhur dhe validuar te dhenat dhe treguesit ,i ka analizuar,i ka rishikuar me dr perkatese duke finalizuar raportin!

Raporti qe po prezantohet sot ne mbledhjen e radhes ne keshillin Bashkiak, eshte publikuar ne faqen zyrtare te bashkise dhe faqet perkatese ne mediat sociale dhe do te perdoret edhe ne konsultimin publik para aprovimit te buxhetit 2024-2026.

1.rritur performancen si ne shpenzime korrente ashtu edhe ne realizimin e investimeve, te cilat gjate 2022 jane realizuar 100%..

2.Është përmirësuar situata financiare falë mirëadministrimit të burimeve financiare dhe punës së mirë të administratës tatimore dhe përdorimit më të kujdesshëm të buxhetit

Policia bashkia ka mbështetur popullatën dhe strukturat e qeverisë vendore dhe asaj qendore duke zgjidhur tërësisht të gjitha rastet e ankesave apo konflikteve në .komunitetit dhe mbështetur IKM-të.



3. Bashkia ka përmirësuar shërbimin e emergjencës civile duke rritur ndjeshëm numrin e rasteve të identifikuara dhe të dëmshpërblyera, rritjen e inspektimeve për ti paraprirë rasteve të rrezikut nga zjarri etj.

4. Bashkia ka përmirësuar rrjetin vaditës dhe kullues duke e bërë atë funksional, për rrjedhojë kjo ka sjellë që në fund të vitit 2022 rreth 90% e tokës bujqësore të mbulohet nga shërbimi i vaditjes dhe kullimit, gjë që ka cuar në rritjen e prodhimit bujqësor të fermerëve lokal.

Bashkia ka plan menaxhimi për të gjithë sipërfaqen pyjore dhe kullotë nën administrimin e saj. Ajo është kujdesur që të shtojë numrin e fidanëve me mbi 3000 rrënjë në sipërfaqen e shfrytëzuar përgjatë vitit 2022.

5. Bashkia ka përmirësuar infrastrukturën rrugorë në territorin e saj, duke shtuar me 22 km linear rrugë të re. Kjo ka sjellë që të gjitha fshatrat të kenë akses në të 36 qendrat që ofrojnë shërbime publike në gjithë bashkinë.

6. Është përmirësuar cilësia e menaxhimit të mbetjeve pa rritur koston mesate për njësi të këtij shërbimi Bashkia depoziton mbetjet e saj në landfillin rajonal të Korcës, dhe mbulon pothuajse tërësisht popullsinë e saj me këtë shërbim (100% në pjesën urbane të saj dhe mbi 80% në pjesën rurale të saj).

Bashkia rritur perpjekjet për mirmbajtjen e ujësjellsit dhe kanalizimeve, për tu qëndruar sa më pranë qytetarëve në nevojat e tyre bazike, në mënyrë që çdo qytetar të furnizohet me ujë. Buxheti i shpenzuar për këtë shërbim është realizuar 100% dhe ky buxhet është përdorur vetëm për investimet.



- Përmirësimi i kushteve në arsimin bazë, parashkollor, dhe atij të mesëm, rritje e vëmendjes për shtresat në nevojë dhe me shumë mbështetje përmes strehimit social, kanë qenë tendencë e bashkisë përgjatë vitit 2022.

Si përfundim:

Gjatë vitit 2022 buxheti i bashkisë është zbatuar në mënyrë të ekuilibruar dhe është realizuar në masën 88%, duke përdorur 93% të të ardhurave të bashkisë.

Përkujdesi social, Arsimi Bazë dhe parashkollor, administrata dhe infrastruktura rrugore janë shërbimet më të financuara nga bashkia gjatë vitit 2022.

Bashkia ka përmirësuar shërbimet e ofruara për komunitetin me anë të një fondi investimesh prej 231.5 milionë lekë, përmes të cilit janë financuar shërbime të tilla si: Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime, Rrjeti rrugor rural, Arsimi Bazë dhe Parashkollor, Strehimi etj. Bashkia ka realizuar investimet për vitin 2022 rreth 56% më të larta sesa ato në vitin 2021. Projektet e investimeve në vitin 2022 janë realizuar në masën 93% krahasuar me planin e këtij viti.

Bashkia ka synuar të përmirësojë eficiencën financiare dhe mirë administrimin e parave duke ofruar më shumë shërbime dhe cilësi më të



lartë të tyre për komunitetin. **Jane marre parasysh prioritetet e komunitetit dhe rezulton se është ndërhyrë për përmirësimin e nevojave te banoreve, sidomos në zonat rurale, sikurse janë rrugët lidhëse të fshtatrave dhe Njësive Administrative, vënia në funksion e veprave vadtëse për tokat bujqësore, apo furnizimi me ujë të pijshëm i banorëve në zonat rurale.**

Bashkia po synon të rrisë eficiencën financiare dhe mirë administrimin e parave duke ofruar më shumë shërbime dhe cilësi më të lartë të tyre për komunitetin.